



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste z. Taulant Balla për të vendosur për përcaktimin e një date të mbledhjes së Kuvendit në seancë plenare më 15.11.2019 me rend dite: “Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës "Mbi nevojën e fillimit të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Vasilika Hysi - Zëvendëskryetare e Kuvendit

Myslim Murizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit

Elisa Spiropali – Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Rudina Hajdari - Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat/Kryetare e Komisionit për Integrimin European

Adriatik Alimadhi - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partive të Djathta

Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Arben Ahmetaj - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Enver Rroshi - Kryetare i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Fatjona Dhimitri- Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Edlira Hyseni - Zëvendëskryetare e Grupit Parlamentar të Pavarur

Mungojnë:

Niko Peleshi – Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Atëherë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve e kam thirrur pasi kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste zoti Balla, mbështetur në nenin 12, pika 2 të Rregullores ka kërkuar thirrjen e Konferencës së Kryetarëve, e cila mbledhet jashtë axhendës kur ka kërkesë nga Këshilli i Ministrave ose kur kërkohet nga grupet parlamentare. Kërkesën që ka bërë zoti Balla e keni të gjithë përpara, e cila është për thirrjen e Konferencës së Kryetarëve, e shoqëruar edhe me një projektrezolutë.

Fjalën e ka zoti Balla për të parashtruar kërkesën.

Taulant Balla - Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit të gjithë anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve!

Siç jeni në dijeni Shqipëria është në një moment të rëndësishëm të konstituimit të Gjykatës Kushtetuese. Përfitoj nga rasti të falënderoj deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, të cilët në shumicë më shumë se 115 anëtarë përmbyllen fazën e parë, do ta quaja të detyrimeve që përfshijnë Kuvendin në këtë proces. Kuvendi ka 3 anëtarë që zgjidhen prej tij. Në fakt, procesi drejtohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Kuvendi e ka të limituar të drejtën e tij për të zgjedhur vetëm 1 ndër 3 kandidatët e propozuar. Kuvendi e ka ushtruar të drejtën për 2 kandidatë, ka edhe 1 kandidat, ndërkohë që Këshilli i Legjislacionit në raportin e tij të mbledhjes së zhvilluar më datën 11 nëntor, ka sqaruar tërësisht procedurat e ndjekura edhe për anëtarët që zgjidhen nga Presidenti i Republikës, në respekt të vendimit të Këshillit të

Legjislacionit, por edhe të qasjes së Kuvendit të Shqipërisë, sepse ka qenë një proces i ndërthurur në këtë rast ndërmjet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Kuvendit të Shqipërisë, por edhe Presidentit të Republikës.

Dje jemi njohur me një dekret nga ana e Presidentit të Republikës për emërimin e një anëtari tjetër të Gjykatës Kushtetuese, në një pozicion të ezauruar, ku ishte njoftuar emërimi i anëtarit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Në këtë situatë të re të krijuar që nuk është e para, por është një rast i përsëritur, i një sjellje të përsëritur të Presidentit të Republikës, i cili lëshon dekrete të pabazuara në Kushtetutë, jashtë çdolloj afati, unë i jam drejtuar institucionit të Kryetarit të Kuvendit dhe për pasojë Konferencës së Kryetarëve që Kuvendi i Shqipërisë si organi themelor i piramidës funksionale të shtetit shqiptar, ne jemi të vetmit të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli shqiptar, të mbajë një qëndrim lidhur me këtë situatë të krijuar. Për fat të mirë Kuvendi i Shqipërisë ka një jurisprudencë të konsoliduar në këtë aspekt prej shumë vitesh, e fundit ka qenë më datën 10 qershor të vitit 2019, kur në kushtet e një akti të ngjashëm në mungesë tërësore të bazuar në Kushtetutë Presidenti i Republikës zhdekretoi, nëse do të përdorja termin, i cili nuk është term kushtetues datën e zgjedhjeve të 30 qershorit. Këtu jemi në rastin kur Presidenti i Republikës pa u bazuar në Kushtetutë, duke e shkelur tërësisht atë për një vend të ezauruar në Gjykatën Kushtetuese na krijon një problem institucional do ta quaja me vijimin e punës së krijimit dhe funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese.

Duke vlerësuar se Gjykata Kushtetuese është një organ që ka për mision rruajtjen e kushtetutshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe kjo gjykatë garanton zbatimin e parimeve themelore kushtetuese nga të gjitha institucionet kushtetuese në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, duke vlerësuar se rriffillimi i funksionalitetit të saj është jetik edhe për zbatimin e objektivave kushtetues të kontrollit, balancën midis pushteteve në vend do t'ju informoj se kemi punuar gjatë gjithë ditës së sotme për të propozuar në Konferencën e Kryetarëve një draft, një projektrezolutë qëndrimi të përbashkët, e cila nuk është një dokument politik, por më shumë se kaq është një dokument i rolit dhe i përgjegjësisë që duhet të marrin në këtë aspekt.

Ne jemi të vetmit të autorizuar nga Kushtetuta që mund t'i drejtohem çdo institucioni tjetër, kujtoj këtu që edhe Presidenti i Republikës është një institucion që zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë. Të mos harrojmë që si të tillë në situatën e krijuar jemi të vetmit që mund t'i bëjmë thirrje çdo institucioni tjetër qoftë Presidenti i Republikës, qoftë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Gjykata Kushtetuese që të veprojnë në konformitet të plotë me Kushtetutën.

Pa dyshim edhe mes nesh këtu ka qasje të ndryshme nëse veprimi i Presidentit është kushtetues ose jo, por në këtë aspekt besoj se të gjithë jemi njohur edhe me arsyetimin shumë

të vyer të bërë nga Këshilli i Legjislacionit më datën 11.11.2019, ku është saktësuar se Kuvendi i Shqipërisë pa dyshim ka zhvilluar një procedurë tejet kushtetuese, tejet të pastër në aspektin e konformitetit me Kushtetutën. Unë nuk dua të bëj një lexim të draftit, të projektit të depozituar, por jemi në kushtet kur është e rëndësishme t'i bëjmë thirrje Presidentit të Republikës për ta rikthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta, të mos marrë asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ajo që është e rëndësishme për të gjithë ne: duhet të garantojmë funksionimin normal të organeve kushtetuese, ku një prej këtyre institucioneve të rëndësishme është Gjykata Kushtetuese. Ne u gëzuar të gjithë në momentin që u konstatua se Gjykata Kushtetuese u bë me 5 anëtarë, pra zonja Arta Vorpsi, e cila buroi nga procesi, ku u përfshi Presidenti dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bëri emërimin e saj, shpalljen në Fletoren Zyrtare. Po ashtu Kuvendi i Shqipërisë 2 anëtarët e tjerë, 1 anëtar është zgjedhur më parë nga Presidenti dhe 1 anëtar tjetër është në detyrë zonja Vitore Tusha. Si i tillë, ky ishte një hap i rëndësishëm, sepse për ta bashkëndarë me ju fakti që ka tashmë 5 anëtarë në Gjykatën Kushtetuese e bën atë funksionale, sepse janë shumë çështje që mund të shqyrtohen edhe vetëm në dhomë këshillimi në kolegjin e gjykatës, pra ka eksperiencë të kahershme në funksionalitetin e saj.

Prandaj, zonja dhe zotërinj anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, unë do të kërkoja për të ruajtur, le të themi atë rol të konsoliduar të eksperiencës parlamentare ndër vite në momente të tilla të rëndësishme, që Kuvendi të shprehet.

Kuvendi në Kushtetutë e ka të përcaktuar mënyrën se si mund të shprehet. Unë kam propozuar të shprehem përmes një rezolute, të cilën pa dyshim grupet parlamentare duhet ta diskutojnë në grupet e tyre parlamentare, ta pasurojnë atë edhe me propozime të tjera, por mendoj se e rëndësishme është që si Kuvend të shprehem për këtë çështje në një seancë plenare, e cila nisur edhe nga fakti që jemi në jetë normale parlamentare, jemi në sesion parlamentar, kërkesa ime është që ajo të zhvillohet nesër në orën 10:00, me qëllim që të jemi në kohë me reagimin tonë institucional.

Gramoz Ruçi - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Murrizi.

Myslim Murrizi - Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, tani po e shikoj rezolutën, nuk më ka ardhur me postën elektronike, kur na lajmëruan për mbledhjen.

Parimisht nuk kam ndonjë gjë kundër rezolutës. Ta shikojmë se çfarë thotë. Për orarin që kërkohet për t'u mbledhur nesër Kuvendi, nuk jam dakord dhe që të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin në funksion të detyrave që mbartim, jo miqësisht edhe ai, edhe ne si Kuvend, ju

shumica, bashkë me votat e pjesës tjetër jemi nxituar sa të duash në këtë valë të Gjykatës Kushtetuese. Asgjë nuk na pengon për të bërë dy seanca rresht për të zgjedhur 2 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në një interval kohe 24 orë, meqenëse po kërkon që të mblidhemi nesër për hiç gjë. Po shikoj në lajme se e zgjedhura me Fletore Zyrtare ka shkuar dhe është betuar te noteri. Inshallah nuk i mbushet mendja ndonjë tjetri të shkojë të betohet në kishë apo në xhami. U bëmë gazi i botës dhe për turpin e të gjithë dynjasë për një grykësi, për një vend pune apo për të nxituar kush e kush mund të çojë miqtë e tij apo ata që kanë lyer “rrotën e qerres” në Gjykatën Kushtetuese. Ajo Gjykatë Kushtetuese çfarëdo që të ndodhë me këto veprimet e këtyre 2-3 ditëve, është më falni për shprehjen “me brekë nëpër këmbë, e pamoralshme”. Nuk do të ketë më moral. Si mundet ta pranoj unë si qytetar i Republikës së Shqipërisë jashtë çdo funksioni që kam anëtar të Gjykatës Kushtetuese një që është betuar te Mine Sharka, noteria nga Lushnja. A ka më turp?! Nëse keni vullnet, jua kemi thënë: hajdeni të vëmë dorë në Kushtetutë! I keni bërë ligjin për reformën në drejtësi apo ndryshimet kushtetuese nën presion për një vizë. E ndryshoni! Keni 6 muaj që kemi nisur një komision hetimor, kemi dërguar edhe anëtarët tanë atje, por as mish as peshk, erdhi edhe Komisioni i Venecia dhe e tha. Ndani mendjen se çfarë do të bëni! Paradite thoni me ne, pasdite me dynjanë. Në fjalën time në parlament ju thashë: nuk është halli i Marsidës por është halli i Arta Vorpsit. Ju qeshët. E vërteta është se Arta ishte e para në të gjitha variantet pa u ulur në asnjë karrige. Pse nuk e kishit parashikuar ju se ai do ta dekretonte Marsidën? Besoj se e keni ditur. Kanalet tuaja të komunikimit me Presidentit janë *non stop*, keni njerëz që ulen në sofër me të. Çfarë do të bëjmë me këtë rezolutë? Do ta pushkatojmë si Mehmet Shehun?! Çfarë zgjidhim? E heqim dot betimin e Artës te noteri?! Ka marrë dhenë kjo gjë. “Zëri i Amerikës”, VOA thotë: “Betohet Arta te noteri”. Inshallah nuk shkon ky tjetri Besniku te Sabri Koçi, meqenëse nuk e qasin ata se nuk ka kaluar vetingun dhe betohet mu në xhami. Është një gatim i pistë, që sinqerisht jua them juve kolegë të maxhorancës, se vjen nga brenda jush. Por nëse nuk e keni kuptuar, do ta merrni vesh: ju ka marrë flakë mullari i bykut dhe nuk po e shihni se i hedhin ujë vërdallë dhe del vetëm tym. Kur t’ju plasë flaka do të habiteni. Luftën e brendshme që keni për ego, për pushtet, për klane, për konjuktura si me Gjykatën Kushtetuese edhe me kampin e SPAK-un që herë i ulni e herë i ngrini nga karriget e qeverisë, mos e rrezatoni si luftë që bëhet në parlament dhe për hatër të shqiptarëve. Zgjidhni së pari problemet me veten! Unë nuk e njoh fare Ardian Dvoranin. Keni pasur të gjitha mundësitë që të mos tallet edhe Ardiani i pari, që të sjellë 4 lista me 5 emra. Të njëjtët emra i çon Presidentit, të njëjtët na i sjell ne. Larg o Zot t’u kishte rënë infarkt 2 vetëve nga ata, ne do të na ishte bllokuar i gjithë procesi. Po pse mbaroi Shqipëria për juristë? Me dhjetëra të tjerë

ka skualifikuar duke mbajtur kot standarde të dyfishta. Nuk keni qejf që të jenë siç kanë qenë ata të tjerët si: Gani Dizdari, Besniku, Ngjela e me radhë. Gjeneri njerëz të rinj nga vetja juaj. Apo nuk doni, sepse ka ikur Luli dhe ne nuk na llogarisni. Se Lulit kur vjen i shkelni syrin për çdo gjë që kërkon të bëni në Kushtetutë. Merrni listën tuaj! Ka juristë sa të duash. Brezi i parë ka mbaruar në vitin 1999. Ka 20 vjet që kanë dalë 20 palë juristë. Pasurojeni atë listë dhe jo ul- shkull: Arta- Besniku, Besniku- Arta, Marsida hyn për kolor me këngën e Sami Kallmit: “Marsida, Marsida ti do të jesh e imja”. E kujt është Marsida? E Likes, juaja, e Enkelejdit apo e noterit? Se edhe Marsida mund të shkojë të betohet te noteri.

Zoti kryetar i Grupit të PS-së unë nuk shikoj se zgjidhim ndonjë gjë me rezolutën. Rezoluta më duket siç i shpallte luftë Enveri Bashkimit Sovjetik: ai në vend të tij, ne në vendin tonë, as ata nuk pyesnin për ne, as ai nuk e kishte në konsideratë atë.

Për mua nëse, ju dëgjon me Komisionin e Ligjeve, me çfarë na jep tagër Kushtetuta thërrisni atë djalë që keni te KED-ja, të hapë një garë tjetër. Nuk e di se cili do të betohet nga këta. Të sjellë listat e treta në Kuvend, ndoshta vjen Arta për t’u zgjedhur. Nuk hyn kjo në punë me betim te noteri. Po ashtu, po shkoj unë, pasi njoh noterë më shumë sesa Arta. A doni ta lë mandatin dhe të shkoj unë anëtar i Gjykatës Kushtetuese?! Dakord jeni? Unë gjej 10 noterë. I sjell këtu në Kuvend me makinë.

Shoh mungesë serioziteti nga këshilltarët apo baballarët e hartimit të reformës në drejtësi nga kokat apo shpikësit e famshëm të këtyre mekanizmave dhe artificave që e kanë gatuar reformën në drejtësi, siç duket e shikojnë se po u rrëshqet nga duart, sepse e gatuan për vete dhe po mësoni si byreku i helmuar i hoxhës.

Jua them sinqerisht, duke qenë pjesë e parlamentit, duke mbajtur jo pak ngarkesë në kurriz, mosdorëzimin e mandatit, e shikoj veten të përlyer dhe të bërë pis në të gjithë këtë katrohurë beteje midis Presidentit dhe parlamentit njëlloj sa ju, pavarësisht se cilat bindje politike kam unë dhe nga cila forcë politike kam ardhur këtu.

Duhet ta shikoni më me gjakftohtësi, duhet t’i pyesni ata që marrin vesh nga ligjet. Jo ata që i shkelin syrin dhe e kanë bërë lëmsh punën, jo ata që kërkojnë të çojnë vetëm baxhanakë, kushërinj, kushërirat e para të grave, çunat e hallës, kushërirat e para të dajave. Ne këtu jetojmë. Ky është aq vend i vogël sa po pyete 2-3 vetë me sms, mbete pa u martuar, se del nusja kushëri. Siç i merrni vesh ju, i marrim vesh edhe ne.

Zoti Balla, po të drejtohem ty drejtpërdrejt, edhe për SPAK-un e ke me ligj të Fatmirit, se do të betohet te Presidenti. Nuk t’i qas. Do të shkoni përsëri te noteri me SPAK-un? Hajdeni vërdallë përsëri! Po nuk janë ata që do ai, nuk jua hap derën e kishës për të vënë dorën në

Kushtetutë. Çfarë do të bëni? Më mirë merrni briskun në dorë. Nuk bëhet kjo punë duke mjekuar plagët me gjethe. Merrni briskun në dorë, çajeni dhe hajdeni, se nuk ka asgjë të keqe. Flisni me burrat a gratë e “Rrugës së Elbasanit” dhe hajdeni të bëjmë një ndryshim kushtetues! Ku ka çaluar, sepse e bëtë me nxitim, hajdeni ta bëjmë! Nuk do t’ju betohen më. Do të shkojnë të betohen te SPAK-u vetëm ata që do ai. Çfarë do t’i bëni deri kur do ta hiqni? Opingat! Gjykatën Kushtetuese nuk e bëni dot që të japë vendimin, nëse do të qëndrojnë në punë me ata apo jo. Si do ta zgjidhni? Ai thotë: “Nëse nuk është nga Skrapari nuk fillon punë në SPAK”. Çfarë i bën ti?! Nuk ta hap derën, e ka si dyqan privat. Ju ka dështuar. Ju punojnë fort njerëz që keni vetë në prehër, i keni në majë të pushtet, si e si ta kapë.

U kënaqa shumë kur dëgjova intervistën. Do t’ju dalë ky problem edhe me prokurorin. M’u kujtua Kosta Barka, si ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale e gjithë fjala ekselente e Olsi Çelës. Foli vetëm për të vobektit, për fukarenjtë, për ngritje të pensioneve, për shtimin e vendeve të punës, për fonde, për makina, por nuk ka asgjë në dorë për to.

A është ky prokuror që la dosjen e Shullazit? Po! A është ky që u bë i sëmurë me leje lindje? Po! Ky është ai që më mbush mendjen mua, dhe juve jua ka mbushur mendjen për arsye të tjera. Ky do të luftojë krimin?! Aty ka qenë ky. Po fliste sikur kishte ardhur si anije kozmike. A keni ju plot refugjatë, që nuk kanë qenë asnjë ditë në Shqipëri, i morët me katapultë nga Kina, Italia, nga Bashkimi Sovjetik dhe i sollët si koka të mëdha të jurisprudencës shqiptare. Ky burri, aty ka qenë që kur ka mbaruar shkollën. Nuk ia kam dëgjuar zërin. Për Zotin më tepër ia kam dëgjuar zërin një polici të qarkullimit, sesa Olsit tuaj.

Uluni me qetësi me njëri-tjetrin, shikoni çfarë duhet të bëni që të vihet dora në plagë për t’i prerë rrugën fenomenit, se keni disa institucione që do të shkojnë tek ai burri, për ta bërë ashtu siç duhet.

Unë nuk besoj se zgjidh gjë rezolute. Nuk e bën funksionale Gjykatën Kushtetuese, aq më tepër me drita ndezur, ditë pushimi, dy vendime të rëndësishme për drejtësinë, kjo që doni t’i thyni hundën këtij dhe një vendim tjetër, kur keni emëruar këto të “kçk”-së, që i quani KPK dhe KPA, i keni bërë ditë të shtune.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njëllonj është, ditë pushimi. E keni bërë më 17 qershor, një javë para zgjedhjeve, me drita ndezur, keni kaluar 27 vetinguesit. 2 që përmjeren buzë Lanës, 3 të tjerë që janë hequr si hajdutë, i keni kaluar këtu ditë të shtune. Çfarë nxitimi keni?!

Unë nuk jam dakord për nesër. Bëni çfarë të keni qejf, ju e keni shumicën. Unë nuk vij nesër. Me drita ndezur, si aksion, si dita e Enverit, si punëtorë kooperative, unë nuk pranoj të

përdorem nga askush. Të gjitha fjalët që përdora nuk kanë lidhje me pjesën politike. Sinqerisht ju shikoj shumë keq dhe duke ju parë keq shikoj keq dhe veten, ndihem i fyer, i ofenduar për çfarë po ndodh nga një sherr apo një oreks mes atyre që mbani në prehër dhe këtij që e zgjodhët vetë dhe ju ka dalë nga prehri.

Nëse nuk keni informacion, por këtë nuk dua ta besoj, por përderisa zien e gjithë Tirana në çdo mejhane se nga ju vjen plumbi, ju nuk e paskeni marrë vesh, nuk e besoj të jeni në narkozë. Ju ruajt Zoti, unë them se jeni të mpirë, por nëse jeni nën narkozë, jeni në gjumë, kur t'ju dalë gjumi është djegur mullari i bykut.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Më fal, Rudina, para se të flas, se ndërpreva zotin Murrizi!

Ju lutem, këtu jemi në Konferencën e Kryetarëve. Mund të kemi mendime nga më të ndryshmet, këndvështrime nga më të ndryshmet, politike, procedurale e të tjera, por të mos e ngatërrojmë Konferencën e Kryetarëve me seancën plenare. Atje shprehet mendimi në lidhje me përmbajtjen e gjësë, atje bëhet edhe votimi për pro ose kundër.

Këtu jemi mbledhur thjesht për një kërkesë që ka bërë grupi parlamentar i maxhorancës, për të thirrur një seancë jashtë radhe, jashtë kalendarit që kemi, për të diskutuar dhe për të miratuar ose jo këtë rezolutë, këtë projekt. Kaq.

Në këtë kuadër, lidhur me çështjet që ngriti zoti Murrizi, dua të bëj nja dy-tri komente.

E para, nuk ka pasur asnjë nxitim nga seanca plenare e kaluar, që ne kemi miratuar dy kandidatët. Përkundrazi, kemi zbatuar pikë për pikë Kushtetutën e ligjin, dhe kemi respektuar një për një atë që ka kërkuar KED-ja si organ i pavarur dhe i ngarkuar nga Kushtetuta për të bërë këtë gjë. Dje ndoqa edhe Presidentin, i cili tha që jo, Kuvendi është sovran, le t'i miratonte një nga një ose të dy bashkë. Kësisoj, të jemi të qartë, që të mos bëhemi pishman për atë që kemi bërë në këtë drejtim. Unë jam shumë skrupuloz në lidhje me këtë. Jua thashë edhe në seancë plenare, që për këtë çështje... Kur mora letrën e Presidentit, menjëherë, se faktikisht Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, në rastin e reformës në drejtësi janë thjesht noterë, po ta shikoni hollë-hollë. Hollë- hollë jemi noterë. Pse? Sepse, në qoftë se nuk i miratojmë, është ajo që i shpall, është KED-ja. Në qoftë se nuk e shpallim nesër SPAK-un, është përsëri KED-ja. në qoftë se s'e shpallim Prokurorin e Përgjithshëm nesër, nuk e zgjedhim ne, është përsëri KLP-ja, s'jemi ne.

Unë ju përgëzoj që ju votuar të gjithë, si Kuvend, me 105 vota, pasi jep edhe kredibilitet institucional një institucioni tepër të rëndësishëm, siç është Gjykata Kushtetuese.

Kjo ishte e para. E dyta, lidhur me këtë betimin. Unë nuk e di, kjo s'është një kandidate e kaluar nga ne, por është një kandidate e cila ka të drejtën e saj të veprojë në mënyrë të pavarur, ku të dojë e si të dojë.

Sigurisht, ne duhet të ndjekim me vëmendje kandidatët që kemi miratuar ne. Presidenti do të zbatojë Kushtetutën, që ty kandidatet tona të bëjnë betimin dhe të fillojnë nga puna? Në qoftë se po, unë nuk e vë në diskutim që Presidenti duhet ta bëjë këtë. Nuk kam pse e paragjykoj paraprakisht. Shpresoj që ai të zbatojë Kushtetutën. Unë ua kam përcjellë shkresën të gjitha institucioneve: ia kam përcjellë Gjykatës Kushtetuese, ia kam përcjellë KED-së, ia kam përcjellë Botimeve të Fletores Zyrtare, ia kam përcjellë Presidentit. Ua kam përcjellë atë që vendosët ju, duke i vënë në dijeni se nga kjo procedurë, këto dy zonja dolën anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

Kam konstatuar se sot KED-ja i ka nxjerrë në Fletoren Zyrtare dy kandidaturat që ne miratuam. Presidentin e kam vënë në dijeni se ky është vendimi i parlamentit. Presim. Do ta bëjë apo s'do ta bëjë, kjo është punë e tij. Sigurisht, nëse do të dalë e drejtë ajo që ju thatë. Në qoftë se do të ketë cedime nga institucioni i Presidentit, siç ka pasur edhe nga presidentë të vendeve të tjera, si në Poloni, në mos gabohem, Rumani, Moldavi, atëherë ekzistojnë praktika të Komisionit të Venecias, të cilat thonë se si veprohet. Por unë nuk e përjashtoj mundësinë... Ju keni shumë të drejtë kur thoni se ndoshta duhet të bëjmë korrigjime në këtë rrugë, edhe kushtetuese. Ç'ndodh nëse nuk bëhet betimi? Nuk fillohet nga puna. Atëherë duhet të bëjmë ndryshime. Duhet të ulemi këtu, në Konferencën e Kryetarëve dhe të themi: si do ta bëjmë këtë punë? Ndodhi ky ngërç. Si do ta bëjmë?

Pra, misioni i të gjithëve ne, si parlamentarë, si ligjvënës, është të mos bëhemi pishman për ato ligje, për ato ndryshime kushtetuese, për atë reformë të rëndësishme që kemi ndërmarrë, me qëllim që ta jetësojmë atë dhe t'i japim këtij vendi institucionet e munguara, që i qëndrojnë si gur në qafë këtij vendi për të hapur negociatat.

Më shumë janë të preokupuar partnerët tanë strategjikë për këtë çështje, se sa vetë ne. Kjo është e pafalshme. Mua më rëndon shumë kjo. Jemi ne që duhet të preokupohemi. Atyre ju faleminderit shumë, sepse kanë qenë aktorë që nga momenti i parë, si dhe kanë qenë gardianë të moscedimit të këtyre punëve.

Kështu, të mos merremi me veprimin që thamë, se ku është betuar e të tjera e të tjera.

Dua të sqaroje dhe një gjë në Konferencën e Kryetarëve. Nuk është kaq e lehtë për juristët. Pse? Qoftë te Presidenti, qoftë këtu në Kuvend, për këto tre vende që janë hapur, Kuvendi ka shpallur që të aplikojnë vetë kandidatët. Nuk kemi të drejtë ne, por as forcat politike, për të futur emra, për të propozuar. Ata aplikojnë vetë. Dhe po ju them: në Kuvend

kanë aplikuar për një vend 15, 23, që gjatë rrugës janë tërhequr vetë ose gjatë rrugës KED-ja nuk i ka kualifikuar. Po ju them se është hapur vendi i tretë, që ka Kuvendi. Në dijeninë time dhe në informacionin që kam unë, dështon vendi i tretë.

Pra, duhet ta rihapim garën. Ja, ju jeni Konferenca e Kryetarëve. Me siguri që do të hapet gara për herë të dytë, për vendin e tretë që ka Kuvendi. Ligjin e njihni, Kushtetutën e njihni. Kërkoni, motivoni, stimuloni çdo jurist që ju njihni, që të aplikojë për këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'kisha gjë në lidhje me atë çështje. Fola për racionalitet të konferencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po shumë mirë bëre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, Rudina!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, unë kisha një pikë tjetër, të cilën do të doja ta shtoja nëse bëhet një seancë tjetër, që është në lidhje me shtyrjen e mandatit të Komisionit për Reformën Zgjedhore. Afati skadon më 28 nëntor. Kemi folur me bashkëkryetarin, që të jetë një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më 28 nëntor mbaron afati i Komisionit për Reformën Zgjedhore.

Kështu që duam të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër! Kemi folur paraprakisht. Bashkëkryetari nuk ndodhet në Shqipëri, gjë që besoj se ju e dini.

Në lidhje me rezolutën për të cilën jemi mbledhur sot, unë kam disa pika që dua t'i shtroj. E para, më duhet të them se dua të rri në linjë me ato që kam thënë në parlament javës së kaluar. Në fakt, ishte përcaktuese mënyra si u soll Presidenti, dhe ne pak a shumë e prisnim atë sjellje. Unë mendoj se këtu të gjitha palët kanë ceduar, sepse nuk kanë dashur të gjejnë një gjuhë konsensuale në lidhje me ngritjen e Gjykatës Kushtetuese. Duhej ta kishit gjetur një gjuhë e përbashkët për ta zgjidhur këtë ngërç, por nuk ndoqët atë rrugë, përkundrazi bëtë që konflikti të thellohej.

Gjithsesi, jemi këtu ku jemi. Tashmë, pasi e pashë këtë rezolutë mendoj se në një farë mënyre, kjo rezolutë tregon se ne po sillemi ndaj Presidentit sikur ishim gjyqtarë, duke marrë ca kompetenca që nuk na takojnë. Po i themi Presidentit, se dekreti yt është i pavlefshëm.

Mendoj se rezoluta ka nevojë të rishikohet, të riformulohet në një lloj mënyre, që ne të mund ta inkurajojmë Presidentin, ose t'i themi atij, që së pari, siç tha edhe kryetari, të thërrasë për betimin kandidatët e përzgjedhur nga Kuvendi, pra të na sigurojë në lidhje me këtë gjë.

E dyta, ta zgjidhim këtë. Pra, dekretin e Presidentit nuk e kemi ne në kompetencë, që të shprehemi nëse një dekret është i vlefshëm apo i pavlefshëm. Kjo nuk është në kompetencën e parlamentit shqiptar, por në fakt, ne duhet ta drejtojmë këtë në gjykatën kompetente, ndoshta në Gjykatën Administrative, juristët e njohin këtë proces edhe më mirë nga ç'mund ta njoh unë, e më pas të ndërmarrim hapat e duhur, me qëllim që të gjejmë një rrugë të mesme, duke mos lejuar të kalohet në konflikt.

Mendoj se me këtë rezolutë do ta thellojmë akoma më shumë konfliktin. Ju e dini shumë mirë sjelljen e Presidentit. Pasi ndodhi në parlament ajo që ndodhi, ai nxori një dekret tjetër. Nëse bëhet kjo rezolutë, ai do të dalë me diçka tjetër. Pra, thirrja sipas së cilës i themi Presidentit se dekreti yt nuk është i vlefshëm, në fakt është kundër Kushtetutës, sepse nuk është kompetenca jonë për të bërë këtë gjë.

Kështu që, ne po vazhdojmë ta shkelim Kushtetutën nga të gjitha anët. Realisht, në këto momente shteti ynë po bie. Sinqerisht, vazhdoj të bëj të njëjtin apel, duke ju thënë se kjo rezolutë mund të riformulohet, që të përshkohet nga një gjuhë më e pranueshme, sepse nuk e kemi në kompetencë t'i themi Presidentit se dekreti që ti ke bërë është i pazbatueshëm, i paligjshëm e të tjera, ose ta inkurajojmë që të mbajë kompetencat e tij kushtetuese. Këto nuk janë fare në tagrin tonë.

Prandaj, do të kërkoja që ta rishikonim rezolutën dhe të riformulonim disa nga fjalitë. Na jepni pak kohë në lidhje me këtë. Mund t'i kërkojmë Presidentit, që të mos vijojë me betimin e Xhaferllarit, të bëjë betimin e atyre të tjerëve, e më pas të mundohemi të gjejmë ndonjë mënyrë më ligjore, për ta bërë këtë rezolutë, duke iu drejtuar një gjykate, për t'i thënë se si mund ta zgjidhim në një mënyrë tjetër.

Ne duhet t'u tregojmë shqiptarëve se kemi një shtet ligjor dhe se po ndjekim rrugë ligjore. Unë jam partizane e kësaj, dhe do të vazhdoj të bëj të njëjtën gjë dhe do të mbaj të njëjtin qëndrim, në respekt të Kushtetutës, për gjetjen e gjuhës së përbashkët. Sepse ky lloj ngërçi nuk ka një zgjidhje tani për tani. Siç e tha edhe kryetari i Kuvendit, patjetër që ne duam të ngrihet sa më shpejt Gjykata Kushtetuese, ndonëse nga ana tjetër s'po na jepet kjo mundësi, sepse gjithnjë e gjejmë veten në një lloj konflikti të hapur.

Ky është propozimi im: ta shtyjmë për të hënë dhe ta shqyrtojmë me vëmendje se si mund ta shikojmë këtë rezolutë, që të jetë më e vlefshme.

Gramoz Ruçi – Tjetër? Urdhëro!

Rudina Hajdari – Sepse e shikoj si një reagim nervozizmi nga ana e zotit Balla, i cili besoj se po shpejtohet pak në reagimin e tij. Janë shenja nervozizmi,

të cilat nuk duhet t'i tregojmë në këto momente. E kemi bërë këtë edhe më parë. Ky është gjykimi im.

Gramoz Ruçi – Zoti Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit, Kryetar!

Parimisht, edhe unë bie dakord që nesër të kemi një rezolutë në Kuvend, sepse në fund të fundit, kjo punë arriti të rezolutat: rezolutë për këtë, rezolutë për atë, rezolutë për këtë tjetër.

Unë jam i bindur se edhe për sa kohë, deri më 24 korrik të 2022-shit kjo punë do të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri më 24 korrik të 2022-shit kjo punë do të jetë, rezolutë pas rezolute, sepse çështja e zbatimit të reformës në drejtësi është çështje parimore. Njëra palë është pro reformës në drejtësi, për ta çuar deri në fund reformën në drejtësi, si reformë politiko-juridike. Sepse, le të mos bëjmë sofizma: reforma kaq të mëdha, në radhë të parë konceptohen politikisht, e pastaj, pas votimit në parlament zbatohen juridikisht. Nga ana tjetër, kemi një palë tjetër, e cila që në ditën e parë është pozicionuar jo në mbështetje të reformës në drejtësi.

Tani si do ta zgjidhim këtë? Shqetësimi kryesor i këtij parlamenti është bërja funksionale e Gjykatës Kushtetuese një orë e më parë. Ky është shqetësim kombëtar, është emergjencë kombëtare. Kjo sepse Gjykata Kushtetuese është garante e funksionimit të sistemit politik dhe kushtetues të vendit. Të gjitha përplasjet politike për probleme të caktuara, qoftë institucionale, qoftë çështje të kompetencës ndërmjet institucioneve kushtetuese të këtij shteti, shkojnë e përplasen në Gjykatën Kushtetuese.

Tani, neve na ka zënë ky taksirat në lidhje me qasjen që bën Presidenti i Republikës. Mirëpo, nga ana tjetër, ne jemi republikë parlamentare, e për këtë jemi mbledhur këtu. Mirë që parlamenti i bën thirrje në rezolutë Presidentit “që të heqë dorë nga tentativat dhe aktet që bllokojnë zbatimin e reformës në drejtësi”, siç thuhet aty, por nuk zgjidhet me thirrje kjo punë.

Më pas, po prapë, në paragrafin e fundit thotë: “Kuvendi i bën thirrje në mënyrë të ripërsëritur”.

Jam dakord me zotin Murrizi, që kjo çështje do zgjidhur një herë e mirë, dhe do të duhet të zgjidhet me ndryshime kushtetuese e ligjore, që në rezolutë të reflektohet jo vetëm fakti se çfarë i kërkohet Presidentit, se atij po dal unë tani në korridor e po i bëj thirrje, jo një herë, por katër herë, duke i thënë: zbato Kushtetutën e ligjin dhe mos blloko Gjykatën Kushtetuese, por Kuvendi duhet të shprehë në rezolutë angazhimin e vet, që ashtu siç ka përcaktuar në 2016-ën, kur miratuam ndryshimet kushtetuese dhe shtatë ligjet bazike të reformës, mekanizmat e zhbllokimit për çdo situatë hipotetike, le të përcaktojë mekanizmat e zhbllokimit edhe në lidhje me formulën e betimit.

Jam plotësisht në të njëjtën gjatësi vale edhe me zotin Murrizi. Sot nuk thërret zonjën

Vorpsi për të bërë betimin, nesër nuk do të thërrasë anëtarët e Gjykatës së Lartë, sepse nuk i pëlqen fotografia e ndonjërit prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë e kështu me radhë. Mirëpo, betimi nuk është element konstituiv, por element ceremonial. E thotë Venecia, por në fund të fundit, ne e kemi lënë si element ceremonial të Presidentit të Republikës, për t'i dhënë edhe një farë solemniteti një anëtar të Gjykatës Kushtetuese ose një anëtar të Gjykatës së Lartë, por kjo nuk mund të pengojë funksionimin e një organi Kushtetues në një sistem demokratik. Është njëllloj si t'i thuash Kuvendit: ti

I votove me 105 vota dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, por unë nuk i lë të hyjnë në gjykatë dhe të fillojnë detyrën, sepse Kushtetuta ma ka dhënë mua betimin.

Prandaj, unë propozoj që në këtë rezolutë të dalë e qartë se çfarë do të bëjmë ne si Kuvend, në këtë rast. Mekanizma zgjidhjeje ka. Pa i rënë ndesh Kushtetutës, do të duhet t'i marrim të gjitha ligjet e reformës në drejtësi, të cilat kanë në formulën e betimit Presidentin e Republikës, që të përcaktojmë mekanizmat e zhblokimit, nëse ka vullnet politik për ta çuar deri në fund zbatimin e reformës në drejtësi. Nëse pastaj fillojmë këtë lojë e pingpongut, për të gjetur zgjidhje momentale për çdo situatë që na vjen, unë nuk mendoj se kjo është zgjidhja e duhur.

Në fund të fundit, sa i takon Presidentit të Republikës, ai ka kohë që ka filluar t'ua marrë dorën dekreteve nul, edhe bllokimit të funksionimit të sistemit. Ne kemi një komision hetimor, të ngritur për Presidentin e Republikës, në lidhje me shkeljen e rëndë të Kushtetutës. Pesëdhjetë e pesë deputetë të këtij parlamenti mendojnë se ai e ka shkelur Kushtetutën kur tentoi të bllokonte funksionimin e demokracisë dhe të sistemit kushtetues e politik të vendit. Kjo e Gjykatës Kushtetuese i duket gjë e vogël atij. Mund t'i duket gjë krejt e vogël. Kësisoj, unë e ftoj Kuvendin, meqenëse do të mblidhemi nesër për këtë rezolutë, sepse është absolutisht e rëndësishme që të kemi një rezolutë, që teksti i rezolutës të jetë më i fortë se sa kaq.

Gramoz Ruçi – Urdhëro? Urdhëroni zonja

Edlira Hyseni – I nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Ky problemi që doli si çështje emergjente nuk më tingëllon i ri dhe i papritur, pasi që në seancën e radhës së kaluar ishte e pritshme që do të krijohet një situatë e tillë, prandaj nuk na duket diçka e paparashikuar. Edhe çështja e Artës, e cila ishte renditur e para në të dyja listat dhe ishte miratuar, por Presidenti e kishte pezulluar, sepse kishte të drejtën e tij për ta miratuar. Të paktën ne si opozitë në diskutimet tona që atëherë e menduam nëse Arta ishte në rregull, nëse do të kalonte apo jo, pasi dukej sikur Arta do të digjej që atëherë. Në fakt, nuk e di pse Arta nuk u fut, por këtë gjë me procedurë mund ta kishte zgjidhur Kuvendi. Ne si opozitë nuk

ishim të bindur që procedura ishte e rregullt 100%, mes nesh u debatua fort mundësia në çështjen e votimit, por iu dha prioritet faktit dhe të gjithë ishim dakord që Gjykata Kushtetuese duhej krijuar. Të gjithë ramë dakord për të votuar pro, ndërsa ata që kishin dilemën e procedurës apo të kushtetutshmërisë nëse ajo ishte zbatuar në rregull do të abstenonin.

Edhe atë ditë mes nesh e diskutuam faktin e dekretimit të Marsidës nga ana Presidenti, pra ishte diçka e pritshme, por problemi qëndron në faktin se gjërat po ndodhnin shumë shpejt.

Kam një pyetje. Me aq sa unë di, në datën 8 nëntor skadonte afati i Presidenti, në datën 11 nëntor miratuam dy kandidatët në Kuvend, në datën 13 Presidenti miratoi Marsidën, a ka ndonjë emergjencë që duhet bërë për nesër, ndonjë çështje afatesh që duhen bërë shpejt? Të jemi të sigurtë, sa i takon rezolutës nuk e kam lexuar, por mendoj se as deputetët e tjerë nuk kanë për ta lexuar, prandaj mendoj se kjo po bëhet thjesht për një formalitet medietik për t'i dhënë mesazh Presidentit, që Kuvendi nuk është dakord me këtë lloj qasjeje që ju po bëni, por në të njëjtën kohë është sikur ta marrësh të mirëqenë që deputetët e opozitës nuk kanë zë, pasi ata nuk do të kenë kohë ta lexojnë rezolutën për të krijuar ndonjë ide dhe për të pasur një variant të tyre apo ndonjë përmirësim. Kjo është diçka shumë e shpejt dhe e pamundur për t'u konsultuar. A është e domosdoshme kjo gjë për nesër, sepse ka disa afate që duhet të përpiqemi t'i respektojmë dhe nëse ajo puna e ditës së hënë, siç tha edhe Rudina është e mundur?

Jam dakord me faktin që rezoluta është më shumë një mjet sensibilizues dhe marrjeje masash dhe për këtë jam dakord që të marrim pjesë dhe të bëhet, pra jam pro. Sa i takon kohës, duhet t'u çohet në kohë deputetëve materiali, sepse në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi të japin ndonjë sugjerim apo të bëjnë ndonjë përmirësim që nesër të jenë të përgatitur në seancë dhe të mos ta marrin si të mirëqenë se e dinë se çfarë do të votohet.

Shpresoj t'ju shërbejë, pasi ende nuk e kam kuptuar nëse do të kalojë Arta, apo Marsida do të rrijë apo do të ikë, çështjet janë ende të paqarta dhe mendoj se shumica e deputetëve do të donin ta kuptonin më qartë situatën. Jam pro përfshirjes së rezolutës, por sa i takon kohës nëse duhet patjetër nesër, për mua do të ishte më mirë që ta shtynim për ditën e hënë, por nëse ka çështje afatesh, të cilat nuk i kam të qarta, më thoni ju.

Faleminderit!

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, shoh se është një situatë jo e mirë politike e krijuar nga 2 apo 3 palë. Si anëtar i Konferencës së Kryetarëve t'ju them të drejtën më duhet të jap kontributin tim apo ndonjë ide se si e shoh ecurinë e këtij procesi. Dua ta filloj aty ku e la zoti Manja, pasi ju keni eksperiencë më shumë sesa ne. A nuk jemi duke shpejtuar me ngritjen e komisionit hetimor për Presidentit dhe këtë shkojmë me një rezolutë tjetër, duke vënë në përplasje institucionin e Kuvendit me

komisionin hetimor? Pra, është një veprim dhe një normë juridike sikur po e ngremë Kuvendin me një rezolutë tjetër po për Presidentin, anashkalojmë komisionin hetimor për punën e tij. Unë mendoj se kemi një përplasje institucionale dhe kjo nuk është diçka e mirë sidomos përballë opinionit publik. Të paktën ne si përfaqësues të Konferencës së Kryetarëve duhet të jemi të pjekur dhe të kujdesshëm me normat juridike. Nuk mund të themi që kemi shkuar me një rezolutë në Kuvend dhe po thërrasim prapë një seancë plenare, e cila më duket e shpejtuar, përsëri me një rezolutë tjetër po për Presidentin. A nuk kemi një ngarkesë të njëpasnjëshme?

Një komision hetimor i ngritur, më falni se përsërita disa herë, dhe tashmë po shkojmë në seancë plenare. Është më mirë, sipas mendimit tim, t'ia lëmë punën komisionit sesa të thërrasim një seancë tjetër, duke i bërë Presidentit një presion politik. Unë kërkoj, duke qenë i pranishëm në këtë konferencë, të paktën nga ana jonë të mos vijë diçka jo e lezetshme ndaj Presidentit. Opinioni publik duhet ta kuptojë që Kuvendi dhe Konferenca e Kryetarëve po e lënë Presidentin, pasi ai tashmë e ka marrë revanshin e tij, duke gabuar dhe duke shkelur Kushtetutën e të tjera, t'i japim kohën e duhur në mënyrë që ai të ndëshkohet vetë nga veprimet e tij sesa të shpejtojmë me lëvizje politike, të cilat e dëmtojnë tërësisht procesin.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

T'ju them të drejtën jam dakord me disa nga diskutimet që u mbajtën lidhur me projektrezolutën për të cilën do të bëhet edhe seanca e nesërme, por do t'ju sugjeroja dy gjëra.

Së pari, jam dakord në parim me këtë rezolutë, sepse është e nevojshme që Kuvendi të shprehë një qëndrim për gjendjen në të cilën jemi. Rezolutës i duhet shtuar baza ligjore, sepse mungon, që është ajo që parashikohet në Rregulloren e Kuvendit, por besoj edhe ligji që përmban të gjitha ndryshimet që u sollën në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Nuk duhet të harrojmë që për ngritjen e institucioneve të ndryshme ka edhe afate. Pra, në një farë mënyre ligji drejtpërsëdrejti na imponon që të jemi të kujdesshëm në respektimin e atyre afateve ose në justifikimin ligjor pse disa afate janë tejkaluar.

Do të isha për një rezolutë më koncize, më të përmbledhur dhe më largpamëse. Përtej çdo diskutimi ne nuk mund të jemi indiferentë ndaj faktit, që dy nga kandidatët që i ka dekretuar Presidenti i Republikës janë në një situatë të paqartë në lidhje me vetingun. Për njërin ka një vendim javën që vjen dhe për zonjën Xhaferllari ka një situatë të tillë që KPK-ja nuk ia ka njohur statusin e magjistrates dhe për këtë shkak nuk e ka shqyrtuar fare situatën e saj, për kohën kur ajo ka punuar si gjyqtare, ka punuar për një periudhë kohe mjaft të gjatë si gjyqtare e shkallës së parë në Fier, po ashtu di se ka edhe një datë nga Kolegji i Apelit.

Është shumë e rëndësishme që ne t'i ftojmë institucionet e vetingut që këto

vendimmarrje të mos t'i shtyjnë, sepse vendimmarrja për zonjën Xhaferllari dhe zotin Muçi janë vendimmarrje të KPK-së të marra para disa muajsh. Kjo vendimmarrje na duhet dhe nuk duhet shtyrë, sepse ne duhet të parashikojmë në çdo rast hapat që do të duhet të bëjmë. Nëse vërtetë duam të sigurojmë funksionimin normal të Gjykatës Kushtetuese, kjo gjykatë nuk funksionon nëse nuk ka 5 anëtarët dhe nuk arrijnë të marrin vendime nëse nuk bëhen 6 anëtarë. Duhet ta kemi në vëmendje këtë pjesë dhe mendoj se kjo duhet të përfshihet në rezolutë dhe neve na takon ta bëjmë këtë gjë, patjetër. Ne nuk mund të dalim jashtë përgjegjësive, pavarësisht se themi që për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve kushtetuese jemi munduar t'ia largojmë politikës dhe t'ia lëmë institucioneve të pavarura, por në fund të ditës politika ka përgjegjësitë e veta, se ne për këtë punë jemi zgjedhur, të mos menaxhojmë vetëm pasojat, por të bëjmë edhe ato detyra shtëpie që na takojnë për t'i vënë institucionet në lëvizje, sepse detyrimi i tyre i parë është të mos marrin kohë për t'i shtyrë proceset, por të përgjigjen në kohën e duhur.

Ky është propozimi që unë kam në lidhje me përmbajtjen e rezolutës.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që situata në popull është bërë shumë e lodhshme. Ngado që të shohësh është një zgjatje dhe një stres i pafund. Edhe komisionet e vetingut dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi le të punojnë 24 orë, sidomos kur ka emergjencë, si ajo që përmendi parafolësi, t'i shqyrtojnë e kalon apo nuk e kalon komisionin e vetingut, ndryshe kjo gjë e ul shumë seriozitetin e parlamentit me rezoluta ndaj Presidentit. Ne sikur e përkëdhelim Presidentin, por ndërkohë duhet të dalim me nisma ligjore. Çfarë duhet të bëjmë? Jam plotësisht dakord me Ulsin dhe të tjerët, se çfarë duhet të bëjmë për ta ndryshuar dhe përmirësuar punën e këtyre komisioneve që kanë 3 vjet e gjysmë, që nga qershori i 2016-s e deri më sot në 2019-n. Janë bërë luftëra botërore dhe kanë përfunduar me fitore apo me humbje, ndërsa sot në kohë paqeje, me kushte ideale, me dritë, me makina, me rroga, me të gjitha mundësitë për të punuar kemi 3 vjet e gjysmë e mezi po provojmë 4, 5 apo 6 veta. Kjo është një paaftësi e madhe, ndoshta paaftësia e të gjitha institucioneve.

Unë mendoj se parlamentit i ulet shumë serioziteti me rezoluta. Ka një komision hetimor për të shkarkuar Presidentin, ndërkohë që ne sikur e përkëdhelim, duke i thënë hajde se po ta japim edhe një herë dorën, ndërkohë që ai ka tjetër nismë, ai mund të ta tërheqë veshin. Ne duhet të jemi një parlament serioz, të rrimë edhe 24 orë dhe t'i bëjmë ndryshimet ligjore për vetingun e për çdo gjë tjetër, nuk e di nëse kemi kompetencë apo jo, pasi nuk e njoh këtë gjë, t'i thërrasim dhe të raportojnë në Kuvend në komisione për punën që bëjnë. Ku pengohet

puna? Informacionet që ata i kanë atje pse nuk i nxjerrin? Çfarë halli kanë? Kemi muaj të tërë që merremi me këtë gjë, kjo në radhë të parë kthehet në një bumerang për ju që jeni maxhorancë, por edhe për të gjithë njerëzit brenda dhe jashtë vendit, si dhe për partnerët ndërkombëtarë, është diçka shumë e lodhshme. Iku shtatori, hyri tetori, doli nëntori, po mbush 6 muaj komisioni hetimor që u ngrit për Metën, që nga korriku, erdhi Venecia dhe asnjë përfundim, ndërkohë që ai po shkel këtë, nesër do të shkel diçka tjetër. Është një gjendje totalisht joserioze, sidomos për parlamentin që është organi ligjvënës në Shqipëri, sepse atje është një person, ndërsa këtu jemi gjithë këta persona. E gjithë kjo infrastrukturë, e cila ka juristë, konstitucionalistë dhe me të gjithë këshilltarët e mundshëm që mund të na thonë se çfarë duhet të ndryshojmë. Ndryshojeni dhe silleni, ne jemi gati vetëm që këto institucione të formohen sa më parë që njerëzit të mos enden më rrugëve, duke i dhënë mundësinë shtetit shqiptar që të bëhet të paktën një herë në Shqipëri.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Kryetar!

Sot kemi pasur një punë të gjatë nëpër komisione pasi kemi diskutuar projektbuxhetin. Sa i takon projektrezolutës jam kundër zhvillimit të saj në seancë plenare. Si ka mundësi, zoti Balla, gjithmonë pas një konference për shtyp të Presidentit apo pas një dekreti apo akti të tij, ju, si maxhorancë ndërmerrni nisma të tilla për t'i imponuar gjithmonë zgjidhje Presidentit për veprimet e tij.

Nuk po e gjykoj ligjshmërinë e dekretit, pasi mendoj se është vetë gjykata që i gjykon ato dhe nuk jemi ne që t'i imponojmë zgjidhje Presidentit për aktet e tij. Mendoj se nuk është i nevojshëm realizimi i një projektrezolute. Ky është qëndrimi juaj, ndërsa ne kemi qëndrimet tona.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Nëse kjo rezolutë do të bëhet për nesër, ne e kemi gati të pamundur që nesër të depozitojmë sugjerimet tona. Zoti Balla, gjatë fjalës suaj u shprehët se do ta diskutonit edhe me grupet e tjera parlamentare, kështu që na duhet më shumë kohë për të folur me anëtarët e tjerë dhe të shohim se si mund ta ndryshojmë apo të propozojmë amendimet tona.

Nëse ju nuk do ta merrni këtë gjë në konsideratë, kjo është zgjidhja juaj, askush nuk ju ndalon të bëni një rezolutë, numrat i keni. Ne e kemi shumë të vështirë që ta bëjmë nesër, pasi kemi edhe takime të parashikuara në Kosovë me zotin Murrizi dhe nuk mundemi t'i anulojmë dot në momentin e fundit, pasi është takim zyrtar.

Do t'ju propozoja ta shtynim për ditën e hënë dhe më pas është në dorën tuaj se çfarë do të bëni.

Faleminderit!

Taulant Balla – Mendoj që çdo anëtar i Kuvendit të Shqipërisë nuk ka një agjendë, nuk e kuptoj... Është çështje respekti ndaj çdo kolegu, edhe kur flet zonja Hajdari, edhe kur flet ministri i ftuar duhet të ketë një...

Ndjesë për parantezën.

Së pari, nuk besoj që një deputet mund të ketë agjendë më të rëndësishme, të paktën për këtë legjislaturë të këtij parlamenti, sesa vijimi i implementimit të reformës në drejtësi. Nuk e fsheh faktin që një prej arsyeve që shqiptarët na besuan në shumicë me 48% të votave në zgjedhjet e kaluara ishte angazhimi ynë për ta çuar përpara këtë reformë.

Bie dakord me shqetësimin e zotit Roshi, që jemi vonuar shumë, procedurat kanë qenë të koklavitura, për ta thënë shqip, për t'iu përafuar sadopak gjuhës së zotit Murrizi, por për fat mirë jemi në një moment ku të gjitha institucionet e reja janë ngritur, në kuptimin e atyre që bëjnë emërtesat, si Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Unë nuk jam kurrë nervoz, më besoni, kurrë! Si kryetar i këtij grupi parlamentar gjithmonë jam munduar që paraprakisht me drejtuesit e grupeve parlamentare të opozitës, edhe paraardhësit tuaj, t'i vë në dijeni paraprakisht. Në demokraci parimi është të mundohesh të arrish sa më shumë konsensus, por pa dyshim që qasja jonë në këtë situatë është kjo. U tha këtu pse e kemi me kaq nxitim?

Çdo ditë ju dhe ne diskutojmë që vendi ka ngelur pa Gjykatë Kushtetuese. Është e vërtetë, më mirë se të kishim shejtanin brenda, shejtanin e abortuam dhe tani po lindin institucionet e reja. Edhe një ditë është e humbur. A duhet të shprehet Kuvendi i Shqipërisë? Merrni dhe lexoni Kushtetutën e vendit. Ne jemi institucioni më i rëndësishëm, jemi republikë e pastër parlamentare.

U tha që të fusnim në Kushtetutë apo në ligjet organike të institucioneve përkatëse më shumë instrumente zhbllokues. Unë jam dakord, pasi është e papranueshme t'i thuash Presidentit ke 30 ditë kohë, në krye të 30 ditëve Këshilli i Emërimeve në Drejtësi emëron dhe ti më pas i lë po Presidentit të drejtën për të organizuar procesin e betimit, apo jo. Edhe kjo mendoj se është e zgjidhur. Pse? Sepse, pikë së pari, kjo çështje është qartësuar nga Komisioni i Venecias. Komisioni i Venecias e ka tashmë një opinion për këtë çështje. Në rastin e Ukrainës, kujtoj këtu që opinionet e Komisionit të Venecias janë sugjeruese jo vetëm për kazusin e rastit në fjalë, por për çdo lloj kazusi me përmbajtje të ngjashme, kur parlamenti i Ukrainës nuk pranoi të kryej betimi i dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të zgjedhur nga organet e tjera, kjo çështje u kthye në një krizë politike në vend, atëherë Komisioni i Venecias tha: "Duhet të ketë pa dyshim një mekanizëm zhbllokues, se në fund të fundit duhet ta kuptojmë që betimi është akt ceremonial". Unë nuk bie aspak dakord me qasjen e zëdhënësit të Presidentit të

Republikës sot, i cili e krahason noteren me parukjeren dhe as me qasjen e zotit Murrizi këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, do të shkoj edhe te komisioni hetimor!

Komisioni hetimor ka një mandat dhe është në ushtrim të detyrave të veta. Unë, që më keni këtu përballë, e kam shprehur pozicionin tim, jam për ta shkarkuar Ilir Metën, por unë kam shprehur argumentet dhe është komisioni që do t'i vërtetojë argumentet. Kjo është procedurë kushtetuese. Unë nuk kam as nervozizëm dhe as dëshira, sepse pa dyshim që të shkarkohet Presidenti i Republikës duhet të paktën 94 deputetë për ta mbështetur. Mua më përjashtoni nga kjo, ndoshta edhe kolegë të tjerë këtu, sepse ish-miku im Ilir Meta më ka akuzuar për mungesë dinjiteti njerëzor dhe shoqëror. Kjo është njëllë sikur në pyll do ta bëjë gjyqin dhelpra për çështje nderi. Unë nuk kam këtu asgjë personale me Ilir Metën. Do të doja edhe një herë t'u thosha deputetëve, se ky është një draft i bërë në shpejtësi për të krijuar mundësinë që të mblidhet Konferenca e Kryetarëve. Bie dakord që kjo çështje ka nevojë për përmirësime, pa dyshim dhe ato që propozuan zoti Manja, zonja Felaj dhe ju janë të drejta, por të them të drejtën kjo nuk ka lidhje me këtë çështje.

Vizita në Kosovë është shumë e rëndësishme dhe sapo fituam një betejë të rëndësishme para pak minutash në Paris për raporterin për Kosovën me një rezultat të thellë në favor të një raporterit gjerman kundër një kandidati për raporter rus, 30 me 6 nga vlerësimi, vetëm votat e Rusisë dhe të Serbisë ka marrë rusi. Kjo është një punë shumë e mirë që ka bërë Kuvendi i Shqipërisë në këtë aspekt. Pra, do të kërkoja që seanca të zhvillohet nesër në orën 10:00, mund të ishte vetëm një diskutim në emër të grupeve, unë, për shembull, jam konsultuar me grupin tim parlamentar, dhe ndoshta edhe ju do të keni kohë të konsultoheni me grupet parlamentare.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kryetar!

E para, ne e kemi treguar vullnetin tonë, sepse ishim aty dhe e pamë shumë mirë që u miratuan kandidaturat për Gjykatën Kushtetuese me 105 vota, pra tregon qartë se ne e kemi vullnetin, kështu që nuk ke pse të na bësh moral që duhet të jemi nesër patjetër aty për të treguar vullnetin tonë. Kjo është e patolerueshme, pasi ne e kemi treguar vullnetin tonë dhe në këtë pikë nuk ke pse merresh fare me ne. Kjo është një rezolutë e cila flet pavlefshmërinë e dekretit të Presidentit, është një rezolutë juaja, kështu e keni menduar të veproni dhe është në të drejtën tuaj, por nga ana tjetër ne kemi të drejtën tonë të propozojmë amendimet tona, mënyrën se si ne duam që kjo rezolutë të marrë formën e duhur. Kjo është në shërbim të asaj që sapo thatë. Ju nuk na jepni kohën e duhur, kështu që këtë çështje mund ta zgjidhni vetë, prandaj nuk kam se çfarë të shtoj më shumë se kaq.

Gramoz Ruçi – Më lejoni të them edhe unë 4-5 gjëra. Të mos shihet problemi “parlamenti dhe Presidenti”, se nuk është ky qëllimi. Ka ndodhur diçka më e madhe. Çfarë? Me veprimet dhe mosveprimet e dy institucioneve kryesore të këtij vendi, ne si Shqipëri, nuk bëjmë funksionale Gjykatën Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ne jemi mbi ta, jemi mbi gjithçka KED-ja, KLP-ja, KLGJ-ja, të cilave u kemi dhënë infrastrukturën kushtetuese dhe ligjore, dhe të gjitha gjërat monitorohet nga ky Kuvend, se jemi republikë parlamentare.

Është vënë në diskutim hapja e negociatave të Shqipërisë për ato 9 kushtet e Gjermanisë, quajini si të doni, që në fakt, janë të Shqipërisë, pra janë mospërbushje e detyrave të Shqipërisë si rezultat i këtyre kungulleshkave, që në nxjerrim hap pas hapi. Ç’do të ndodhte sikur parlamenti të plotësonte 3 vakancat e veta, Presidenti të plotësonte 3 vakancat e veta, një zonjë është atje, bëhen 7 anëtarë, dhe 3 që duhet të sjellë Gjykata e Lartë, por që nuk mund të vijjnë se vetë Gjykata e Lartë nuk është ngritur, por ama me 7 anëtarë gjykata është 100% funksionale. Ne jo vetëm që nuk e çojmë me 7 anëtarë, por humbasim përfundimisht shansin edhe për 5 anëtarë. Pse? Sepse parlamenti i çoi 2, nga 2 që kishte Presidenti njërin e çoi për të njëjtin vend, se një ia jep ligji e një dekreti, pra dy veta në një karrige nuk mund të ulen, kështu që nuk plotësohet numri 5, Atëherë nuk është funksionale. Këtu ju e shtruat të gjithë se kush do ta zgjidhë? E zgjidh vetëm një institucion? Kjo që nuk po ngrihet, pra Gjykata Kushtetuese. A e kuptoni që e kemi futur vendin në një rreth vicioz?

Le ta vërë veten secili nga ne këtu në rolin e një eurodeputeti gjerman, francez, hollandez, skocez. Nuk janë ata që do të bëjnë detyrat tona të shtëpisë, por ne dhe në një republikë parlamentare parlamenti duhet të dalë mbi palët.

Ky është shqetësimi i parë që kam, i dyti është kjo reformë. Që nga momenti që u ideua në këtë sallë, shumica e kolegëve të opozitës nuk kanë qenë këtu, është iniciuar vetëm nga Kuvendi dhe me dëshirën e Kuvendit është pranuar që do të ketë, quajeni tutorë, apo si të doni, partnerët tanë strategjik ndërkombëtarë, që janë hap pas hapi që nga hartimi i neneve të Kushtetutës, te 30 projektligjet e paketës, te monitorimi i KED-së, KLP-së, KLGJ-së e deri tek organet të vetë atje.

Po ju them që të gjithë në mbrëmë fjetëm gjumë. Dy institucione të huaja që ndjekin reformën në drejtësi, kanë qëndruar deri në orën 3 të mëngjesit, kurse ne flinim gjumë. Unë shtroj pyetjen: ky qëndrim i impenjon, i inkurajon këto institucione ndërkombëtare, që kanë dy vjet që japin kontribut për çështjen? Këtë duhet të themi në një nga pikat e rezolutës.

Po vihet në diskutim vendosmëria jonë që kjo reformë nuk ka kthim pas nga ndërkombëtarët dhe nga shqiptarët. A duhet të shprehemi ne që Kuvendi i Shqipërisë po punon që kjo reformë të ecë para dhe se nuk ka kthim pas? Këtë duhet të shprehë rezoluta.

Këto organe që janë ngritur, pra KED-ja, KLP-ja, KLGJ-ja, organi i vetingut, janë tronditur nga kjo situatë, apo janë komodë në punën e tyre? Jo, janë tronditur. A duhet të shprehemi ne që t'i inkurajojmë ato në punën dhe veprimtarinë e tyre që s'ka? Kuvendi është avokati i tyre prandaj duhet të shprehet me rezolutë. Edhe ne nuk jemi të përkryer, por koha na nxori probleme të reja. Cilat? Ne pa dashje, nga dija apo nga padija, nga vakumi që kanë paragrafët që kemi miratuar, në Kushtetutë, apo në paketën ligjore kemi krijuar pengesa dhe jemi ne i vetmi institucion, që duhet të ndërmarrë nisma për të përcaktuar ato që u quajten këtu valvula, që e zhbllokojnë situatën, jo për ta bllokuar. Kush përveç nesh duhet ta bëjë këtë punë? Prandaj çështja këtu nuk është thjesht procedurale, nuk është që thjesht të shprehemi për një dekret, për një çështje. Për mua problemi është më i madh dhe jam dakord që rezoluta duhet parë në të gjitha këto aspekte, unë përmenda 4-5, ju mund të përmendni 50. Mendoj se kemi kohë që të punojmë dhe të japim të gjithë kontributin tonë për përmirësimin e rezolutës. Në shqiptarët kemi një zakon që po jua them: mund ta lini edhe në fund të muajit, por prapë ditën e fundit dhe orën e fundit të atij muaji do të hidhni gjërat tuaja në rezolutë, se jam vetë i tillë, kam qenë edhe unë në vendin tuaj.

Prandaj, ju lutem shumë të mos e shihni këtë si një luftë politike mes grupimeve politike, por ta shihni më kombëtarisht, sepse ka të bëjë me fatet e shtetit. A duhet ta lëmë ne shtetin të bjerë? Në asnjë mënyrë, ne jemi këtu që të ngremë institucionet e këtij shteti në atë nivel që duan qytetarët, të cilët na kanë deleguar me vullnetin e tyre që të jemi këtu. Për këtë jemi këtu. Nëse do të ruajmë komoditetin që dita e premte është dita e fundit e *weekend*-it, unë nuk e shikoj kështu, por e shoh me këtë shqetësim. Më kuptoni drejt! Më falni, për mungesën e modestisë nga përvoja prej 3 dekadash që kam në këtë sallë!

Mendoj që ju bëtë kërkesë me të drejtë dhe jam absolutisht dakord, prandaj u mundova t'i përmbledh ato që thatë me shqetësimin që të bashkëpunojmë, të koordinojmë, të bashkëveprojmë me njëri-tjetrin, me qëllim që ta shohim me këtë sy dhe jo sikur kemi vënë në tabelën e qitjes institucionin e Presidentit. Në një karrige kanë vajtur dy vetë dhe sigurisht që rezoluta do të shprehet, është një problem që nuk e zgjidhim dot ne. Por çfarë kemi ne në dorë? Ne kemi në dorë merakun që kanë shqiptarët dhe ndërkombëtarët që Gjykata Kushtetuese të bëhet funksionale brenda vitit. Këtu kemi përgjegjësi të gjithë ne, unë i pari, ju të dytët, se është hapur aplikimi për vendin e tretë që ka Kuvendi, por kandidatët po dështojnë njëri pas tjetrit dhe ne themi se e ka KED-ja këtë”, ose se ligji ua njeh vetë të drejtën...”. Pse nuk motivojmë

njerëz ne, përderisa themi që kemi juristë me bollëk? Por ja që del se nuk i kemi të tillë. Prandaj ju lutem të gjeni kohën! Nëse nuk doni sot në orën 10:00, ta bëjmë në orën 12:00, nëse nuk doni në 12:00 ta shtyjme në orën 15:00, nëse nuk doni as në orën 15:00 e shtyjme në orën 18:00. Ta shohim me këtë maturi dhe pjekuri e, mbi të gjitha më këtë përgjegjshmëri, që të japim një mesazh të qartë! Të tjerët po diskutojnë në kancelaritë e tyre. A e keni parë që PE-ja mbledhet dhe diskuton me emergjencë jashtë çdo programi, jashtë çdo kalendari rezolutën për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ne shqiptarët duam kohë. Kam qenë i pranishëm në një vizitë dhe nuk e dija që parlamenti do ta gjykonte këtë, se nuk ishte në agjendë dhe u mbledhëm për këtë çështje. Të gjithë ndërkombëtarët, qoftë dhe Franca, po e diskutojnë. “Po, do ta rishohim në samitin e radhës” thonë ata. Por si do ta rishohin? Duke mos plotësuar ne asnjë detyrë shtëpie? Çfarë do të na shohin ata ne, duke mos parë asnjë lloj serioziteti në këtë vend?

Ju lutem shumë të jemi përgjegjshëm dhe seriozë! Me këtë rezolutë nuk është se do të zgjidhim gjë, por ama do t’i japim një mesazh opinionit publik shqiptar, ndërkombëtarëve, kancelarive, një mesazh mbështetjeje institucioneve, që merren me kurorëzimin e reformës në drejtësi, partnerëve tanë ndërkombëtarë, që asistojnë reformën tonë në drejtësi, duke shprehur në këtë mënyrë vullnetin tonë si ligjvënës për të lënë çdo punë që të zgjidhim çdo nismë ligjore që mund të realizojë dhe të konkretizojë reformën në drejtësi, si dhe 7 detyrat e shtëpisë që na i kërkojnë.

Mendoni për një çast sikur në fund të dhjetorit ne të kishim Gjykatën Kushtetuese, Prokurorin e Përgjithshëm, SPAK-un, Inspektorin e Përgjithshëm dhe plotësimin, aq sa është e mundur, të Gjykatës Kushtetuese. A e kuptoni se si ndryshon rrota e historisë për vlerësimin e Shqipërisë? Duke e parë në këtë këndvështrim, unë do të kërkoja mirëkuptimin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por a biem dakord për këtë gjuhë? Atëherë hajdeni ta ulemi e ta shkruajmë! Doni të mos bëhet në orën 10:00, por në një orar tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo në çdo orë, se duhet të vendosim një orar.

Të lutem, Rudina!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për cilën orë jeni dakord për nesër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më keni në dispozicion edhe në 12 të natës. Doni në orën 7 të mëngjesit? Dakord. Doni në 12 të natës? Dakord.

Taulant Balla – Me leje, zoti Kryetar?

Besoj se seanca do të ketë diskutime, nuk do të jetë thjesht një akt votimi, se nga eksperiencia seancat fillojnë në orën 10:00 dhe gjatë kohës së diskutimeve përfaqësues të grupeve parlamentare mund të ulen ta redaktojnë. Në Grupin Parlamentar Demokrat, dhe në Grupin Parlamentar të Pavarur, në grupin tonë, por edhe në grupin e drejtuar nga zoti Alimadhi, ka plot ekspertë, që mund të ulen të redaktojnë, formulojnë dhe të diskutojnë një tekst. Unë bie dakord edhe me faktin që shpeshherë kryetari i grupit të mos jetë i pranishëm për një agjendë të rëndësishme, por mjafton që një përfaqësues i Grupit Parlamentar Demokrat të mbajë një qëndrim të qartësuar me zonjën Hajdari, si kryetare e këtij grupi. Kini parasysh një gjë: i rëndësishëm është vullneti politik, pra ne duhet të shprehim një vullnet politik për të çuar përpara reformën në drejtësi. Kaq është teksti. Askush nuk mund të pengojë më ecjen përpara të kësaj referomë, si ne, ashtu dhe ju dhe për këtë nuk kemi dyshime.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Unë kam edhe një gjë tjetër. Do t'ju lutesha shumë që debati mes nesh të mos politizohet, por të jemi ne dhe shqetësimi që kemi për ngritjen e këtyre institucioneve. Që të bëhet kjo duhet unifikuar qëndrimi dhe mendimi për rezolutën, për projektin, pra duhen hedhur dhe pritur jashtë debatit parlamentar rregullimet përkatëse, pastaj nga një përfaqësi e çdo grupi parlamentar votohet dhe kaq. Këtë e kam si këshillë, ju mund të doni të flisni, ta politizoni e ta ktheni në debat politik, por unë nuk do ta dëshiroja këtë, se nuk i shërbejmë vendit nëse e politizojmë duke sulmuar.

Në ç'orë ta lëmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni ta depozitoni? Dakord.

Në orën 10:00 ta lëmë?

Dakord.

Ditë të mbarë!

Mirupafshim!

MBLEDHJA MBYLLET